

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm**, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Igballe Azemi, në lëndën penale kundër të akuzuarit A.A nga Gj, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1359/2016, të datës 21.07.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori Kujtesa Fazliu, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 11.05.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

**A K T G J Y K I M**

I pandehuri **A. A.**, nga i ati **B**, e ëma **R**, e lindur **B**, i lindur më dt... në, me vendbanim në Gj, Rr. 1, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes ekonomike të varfër, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, më parë i pa dënuar, ndërsa nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Sepse më datë 14 Qershor 2016, në intervalin kohor prej orës 20:00-21:00, në Gjilan në parkun e qytetit i pandehuri së bashku me të miturin L.Shi me dashje e kanë sulmuar dhe përdorë forcë fizike ndaj të dëmtuarit-të miturit D. M ashtu që i pandehuri ja kishte marrë jaknën, deri sa ishte në stacionin e autobusëve së bashku me të dëmtuarin dhe e kishte veshur, kishte kërkuar nga i njëjti, që nëse donë me marrë jaknën të shkojnë në park, jaknën e kishte lënë në ulësen e parkut dhe kishte kërkuar nga i dëmtuari që ta marrë jaknën, me ç'rast në momentin që ishte ofruar i dëmtuari për ta marrë jaknën, i pandehuri së bashku me të miturin e kanë sulmuar me grushte dhe shqelma në fytyrë. me çka ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të akuzuarit i shqipton:

**DËNIM ME KUSHT**

Të akuzuarit, i caktohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarimit të dhunshëm.

**A r s y e t i m**

Kundër të pandehurit në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se i njëjti ka kryer veprën penale lëndore të përshkruar më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë qështje penale.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, të mbajtur më datën 11.05.2017, Prokurorja e Shtetit Kujtesa Fazliu deklaroi: me vetë faktin se i akuzuari e ka pranuar fajin dhe janë përmbushur të gjitha kërkesat nga neni 248 par.1 të KPPK-ës, gjendja faktike lidhur me këtë vepër penale tani më nuk është kontestuese. Mbi këtë gjendje faktike rezultojnë edhe elementet themelore të veprës penale të kualifikuara në aspektin juridik si sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 e nenin 31 të

KPRK-ës. Prandaj bazuar në pranimin e fajësisë si dhe të provave materiale të cilat ndodhen në shkresat e lëndës i propozojmë gjykatës që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë me dënim meritor sipas ligjit i cili dënim do të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale si dhe me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj veprë penale, gjithashtu i propozojmë gjykatës që me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit të ketë parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese ashtu edhe ato rënduese.

Në fillim të shqyrtimit fillestar, pas leximit të aktakuzës nga ana e PTH në Gjilan, i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën e PTH dhe veprën penale për të cilën akuzohet, duke theksuar se e pranoj fajësinë për kryerjen e veprës penale e cila më vihet në barrë.

Gjykata, pas dëgjimit të Prokurorit, konstatoi se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, nga neni 248 paragrafi 1 të KPP për pranimin e fajësisë, nga se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; se pranimi është bërë vullnetarisht; se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza.

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike :

Se i akuzuari, ka kryer veprën penale, Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-s në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për të njëjtën është përgjegjës penalisht.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata të pandehurin, e shpalli fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale Sulmi nga neni 187 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 dhe nenin 31 të KPRK-s ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale në fjalë dhe se për të njëjtën është edhe përgjegjës penalisht.

Me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit, gjykata i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, sipas nenit 73 të KP-s, si rrethana lehtësuese, e ka marrë për bazë sjelljen e mirë të akuzuarit gjatë mbajtjes së shqyrtimit fillestar, pranimin e fajësisë, ka shprehur keqardhje, i ka kërkuar falje të dëmtuarit dhe i ka premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale, kurse si rrethanë rënduese, të merret shkalla e përgjegjësisë penale, rrezikshmëria shoqërore dhe lëndimi i shkaktuar të dëmtuarit.

Sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me kusht, ndaj të akuzuarit, është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit, si dhe me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 41 të KPRK-s.

Në kuptim të nenit 368 të KPP palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë, duke u paralajmëruar me rëndësinë e dënimit me kusht dhe kushtet të cilat duhet plotësuar që dënimi me kusht mos të revokohet duke u shëndrruar në dënim efektiv.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike, është marrë duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 450 paragrafi 1-3 të KPP.

Nga të cekurat më lartë, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**P.nr. 898/2016, Më 11.05.2017**

**Sekretarja juridike,**  
Igballe Azemi d.v

**Gj y q t a r i**  
Behar Ymeri d.v

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit, përmes kësaj Gjykate.

